

VENDIM
Nr. 11, datë 17.2.2020

**PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT “PËR ZHVILLIM TË
QËNDRUESHËM”, NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM
PARLAMENTAR PËR EKONOMINË DHE FINANCAT**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet nënkomisioni “Për zhvillim të qëndrueshëm”, në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financat.

II. Fusha e përgjegjësisë së këtij nënkomisioni është zhvillimi ekonomik dhe social, rritja ekonomike e qëndrueshme, realizimi i objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe Agjenda 2030 e OKB-së.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 7 anëtarë, si më poshtë:

- | | | |
|---------------------|------------------|--------------------------------|
| 1. Senida Mesi | kryetare | (PS); |
| 2. Edlira Hyseni | zëvendëskryetare | (Grupi i Pavarur); |
| 3. Milva Ekonomi | anëtare | (PS); |
| 4. Almira Xhembulla | anëtare | (PS); |
| 5. Besnik Bare | anëtar | (PS); |
| 6. Vasil Sterjovski | anëtar | (jashtë grupeve parlamentare); |
| 7. Halil Jakimi | anëtar | (Grupi Demokrat). |

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 17.2.2020